



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2138/3prot.

Tepelenë, më 30.06. 2026

V E N D I M

Nr. 48, datë 26.06.2026

“Për miratim të kërkesës, për dhënie dakordësie për realizimin e ndërhyrjes së rehabilitimit të venddepozitimit të mbetjeve të Bashkisë Tepelenë, pronë e Bashkisë Tepelenë”

Në mbështetje të nenit 8 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor” dhe të nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”; ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 54, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; Ligji nr.57/2025, “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, Kërkesës numër protokolli 425 datë 19.05.2026 të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM) protokolluar në Bashkinë Tepelenë me numër 1004 prot. datë 20.05.2026, për “Kërkesë për dhënie dakordësie për realizimin e ndërhyrjes së rehabilitimit të venddepozitimit të mbetjeve të Bashkisë Tepelenë.”

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën për dhënie dakordësie për realizimin e ndërhyrjes së rehabilitimit të venddepozitimit të mbetjeve të Bashkisë Tepelenë, pronë e Bashkisë Tepelenë i miratuar me Vendimin nr.7 datë 24.03.1998 të KRRT Tepelenë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespondencës ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoritë përkatëse pranë bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI

Miratuar me 12 (dymbëdhjetë) vota

Vota Pro 12 (dymbëdhjetë)vota

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 30.06.2026

Adresa: Sheshi “Lord Bajron” Tepelenë


web: www.tepelena.gov.al

E-mail: info@tepelena.gov.al

PLANIMETRIA E SISTEMIT
 TE DRUGES TE FUSHES TE
 DEPOZITIMIT TE MBETURIAVE
 NAKKOSH.

SULC. 1" 500. 124.60

PUBLIKA E SHQIPËS



TOKE ARE

118.30

PESHA TERTHORE
 SULC. 1" 500

118.30
 11.55
 11.0

11.35

MIRATDIET
Kytori Keshillit Rrethllimut Vemba
TERELEXE
SOTIR ÇEKA



P/DSHP
Borçer, Polaslu

119.75

118.75

117.8

114.55

111

110

ZYRA E URBANITIKES MARS-1998



112

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË RRETHIT
T E P E L E N Ë

V E N D I M
Nr. 7, datë 24.03.1998

PËR MIRATIM SHESHE NDËRTIMI TË PËRHERSHËM NË QYTETIN TEPELENË

Këshilli i Rregullimit të Territorit të rrethit Tepelenë, në mbledhjen e tij të datës 24.3.1998, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga seksioni i urbanistikës dhe Zyra e urbanistikës e Bashkisë Memaliaj "Për miratim sheshe ndërtimi të përhershëm", në bazë të ligjit nr.7693, datë 6.4.1993, ligji nr.8015, datë 15.10.1995 "Për urbanistikën";

V E N D O S I :

I. Të miratojë sheshe ndërtimi të përhershëm në qytetin Tepelenë sipas planimetrisë bashkangjitur me to si më poshtë:

1. Shtesë lokali i Z. Besnik Çela në lagjen "S. Musa" me sip. 40m² lKT.
2. Shtesë banese në banesën 40/1 në lagjen "15 shtatori" me sip. 18 m² për 5 KT.

3. Shesh ndërtimi me sip. 4900 për fushë dekompozimi të plehrave të qytetit Tepelenë në Majkosh në buzë të lumit Bënçë ku bashkohet Vjosa me Bënçën.

II. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Tepelenë, seksioni urbanistikës.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË RRETHIT
Sotir Ceka

Nr. 6/4 Prot.
Datë 6.4. 1998

- Fondi i Këshillit të Rrethit
- Bashkia Tepelenë
- Seksioni i urbanistikës

PËRGJEGJËSE E SEKSIONIT TË URBANISTIKËS
Engjellushe Lala

Engjellushe Lala